



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 362/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.05.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Blerje produkte ushqimore”, me nr. REF-42492-01-29-2018, me fond limit 21,860,242 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Lel” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k. (ish MB Kurti sh.p.k.)
Adresa: Lagjia “Xhevdet Nepravishta”, Rr. “Iljaz Ahmeti”, pranë Fabrikës së Qumështit, Lushnje.

Operatori ekonomik “Lel” sh.p.k.
Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr.7, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.
Adresa: Lagjia “Kastriot”, Rr. “Ramiz Aranitasi”, Fier.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatorët ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorët ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashut, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.01.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Blerje produkte ushqimore*”, me nr. REF-42492-01-29-2018, me fond limit 21,860,242 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.

II.2 Në datën 09.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 16.03.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------------|
| 1. “Sinani Trading” sh.p.k, | 18,000,367 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “LeI” sh.p.k, | 18,992,140 lekë, Skualifikuar; |
| 3. ”Klarida Semanjaku” p.f, | 20,040,034 lekë, Skualifikuar; |

II.4.Në datën 16.03.2018, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

“1. Per drejtuesit qe jane paraqitur Librezat e shendetit, nuk ka asnje dokument qe te vertetoje qe jane shofera. Ambienti i marre me qerra per t’u perdorur per Furre buke, ndodhet ne Libonik te Korces, i cili ndodhet ne nje largesi prej 250 km larg Fierit, largesi kjo qe do te paraqese problematika per furnizimin e rregullt ditor te kopshteve, cerdheve dhe konvikteve duke prishur rendin e perditshem te servirjes se mengjesit ne nje orar te hershem te ketyre te fundit. Si rrjedhje nuk mund te marrim persiper absolutisht kualifikimin tuaj duke patur parasysh keto elemente: relievin e thyer malor; kushtet atmosferike gjate periudhes vjeshte-dimer; defektet qe mund te pesoje mjete gjate rruges etj.”

II.4.1.Në datën 20.03.2018 operatorin ekonomik ankimues “Sinani Trading” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.4.2.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2778/2 Prot. datë 28.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Sinani Trading” sh.p.k, duke e pranuar pjesërisht atë, si dhe duke lënë në fuqi vetëm arsyen e skualifikimit: *”Ambienti i marre me qerra per t’u perdorur per Furre buke, ndodhet ne Libonik te Korces, i cili ndodhet ne nje largesi prej 250 km larg Fierit, largesi kjo qe do te paraqese problematika per furnizimin e rregullt ditor te kopshteve, cerdheve dhe konvikteve duke prishur rendin e perditshem te servirjes se mengjesit ne nje orar te hershem te ketyre te fundit. Si rrjedhje nuk mund te marrim persiper absolutisht kualifikimin tuaj duke patur parasysh keto elemente: relievin e thyer malor; kushtet atmosferike gjate periudhes vjeshte-dimer; defektet qe mund te pesoje mjete gjate rruges etj.”*

II.4.3.Në datën 03.04.2018 operatori ekonomik ankimues “Sinani Trading” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Ne lidhje me arsyetimin e pare te KVO sqarojme se: Kemi praqitur te gjitha dokumentat e kerkuara si kritere kualifikuese ne DST. Akoma me tej, pavaresisht se AK nuk kishte kerkuar dokumentacion shoqerues, per te provuar faktin e mesiperm ne kemi praqitur listepagesat e konfirmuara nga dega e tatimeve per tre muajt e fundit qe i korespondojne dates se hapjes se ofertave. Ne keto listepagesa konfirmohet se punonjesit Adriatik Sinani dhe Arben Trashit per te cilet kemi paraqitur librezat e shendetit, figurojne te siguruar prane kompanise tone dhe per me teper me kodin perkates 8322.03 (shofer). Ne lidhje me arsyetimin e dyte te KVO sqarojme se: Neni 1 pika d) e LPP percakton se AK duhet te sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Ne kete drejtim, ne nuk mund te diskriminohemi per shkak te vendshtrirjes se aktivitetit te shoqerise tone, per sa kohe qe ne arrijme te plotesojme te gjitha kriteret kualifikuese te percaktuara ne DST. Ne si shoqeri kemi marre persiper realizimin e kesaj kontrate sipas kushteve te AK, kemi firmosur specifikimet teknike dhe garantoj me furnizim te rregullt ditor ne kohe dhe cilesi. Me dt 19/03/2018 ne i’u drejtuam me ankese AK nepermjet sherbimit postar, por deri me Dt 03/04/2018 ne nuk kemi marre pergjigje nga AK (Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier) ne lidhje me ankesen tone, bazuar ne nenin 78 te

RrPP. Te ndodhur ne keto kushte, po i drejtohem Komisionit te Prokurimit Publik per te fituar te drejten tone. Per sa me siper argumentuam, kerkojme pezullimin e vazhdimin te procedures dhe kualifikimin e ofertes se shoqerise "Sinani Trading" (MB. KURTI shpk), si oferte qe ploteson te gjitha kushtet kualifikuese te percaktuara ne DST. [...]

II.5.Në datën 16.03.2018, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatori ekonomik "LeI" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

"Mungon librezja e shendetit te nje drejtuesi te mjetit. Per drejtuesin qe eshte paraqitur Libreza e shendetit, nuk ka asnje dokument qe te vertetoje qe eshte shofer."

II.5.1.Në datën 20.03.2018 operatori ekonomik "LeI" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2779/4 Prot. datë 28.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "LeI" sh.p.k, duke e pranuar pjesërisht atë, si dhe duke lënë në fuqi vetëm arsyen e skualifikimit: *"Mungon librezja e shendetit te nje drejtuesi te mjetit"*.

II.5.3.Në datën 04.04.2018 operatori ekonomik ankimues "LeI" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon: *"[...]Lidhur me njoftimin e skualifikimit KVO eshte shprehur me justifikimet se: mungon librezja e shendetit te nje drejtuesi te mjetit. Per drejtuesin qe eshte paraqitur Libreza e Shendetit, nuk ka snje dokument qe te vertetoje qe eshte shofer. Ju bejme me dije se i gjithë shpjegimi i dhene per te refuzuar oferten e Shoqerise "LEL" shpk qe per nga vleresimi i ofertes eshte renditur e dyta, nuk qendron, pasi cilido operator ekonomik per te konkuruar ne nje procedure prokurimi bazohet ne kriteret e pergjithshme dhe te posacme per kualifikim qe paraqet autoriteti kontraktore. Konkretisht i gjithë shpjegimi i dhene per arsyet e refuzimit jane te pasakta. Ne lidhje me mungon librezja e shendetit te nje drejtuesi te mjetit, ju sqarojme se ne dokumentat standarte eshte kerkuar qe te jene ne pronesi ose ne qera 2 automjete, dhe nuk eshte kerkuar qe te jene dy shofere. Ne lidhje mePer drejtuesin qe eshte paraqitur Libreza e Shendetit, nuk ka snje dokument qe te vertetoje qe eshte shofer..., ju sqarojme gjithashtu se ne dokumentat standarte eshte kerkuar -Librezja shendetesore te drejtuesve te mjeteve, te leshuar nga organet kompetente te Ministrise se Shendetesise, dhe nuk eshte kerkuar asnje dokumet qe te vertetohet pozicioni i shoferit ne shoqeri. Si konkluzion i kesaj ankese, bazuar ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, bazuar ne argumentat e siperpermendura gjykojme se justifikimet nga ana e KVOse nuk mund te sherbejne si shkak per refuzim prandaj me kete ankese drejtuar Komisionit te Prokurimit Publik ne kerkojme te rikualifikohemi. Sikurse theksuam keto jane arsye shume devijante per te refuzuar nje opertor ekonomik.[...]"*

II.6.Në datën 16.04.2018, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3338/1prot., datë 11.04.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: “[...]1. Per drejtuesit qe jane paraqitur Librezat e shendetit, nuk ka asnje dokument qe te vertetoje qe jane shofera.[...]”, nga shqyrtimi i dokumentave që Komisioni i Prokurimit Publik disponon në lidhje me këtë procedurë prokurimi, u konstatua si vijon:

III.1.1. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 2778/2 Prot. datë 28.03.2018, kthen përgjigje, duke informuar se pretendimi i operatorit ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k. në lidhje me arsyen e skualifikimit të sipërcituar, është shqyrtuar dhe është marrë parasysh. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ky pretendim i operatorit ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k. është pranuar nga autoriteti kontraktor, ndaj nuk do të merret në shqyrtim në themel pasi nuk ekziston më si objekt ankimi.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sinani Trading” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: “Ambienti i marre me qerra per t’u perdorur per Furre buke, ndodhet ne Libonik te Korces, i cili ndodhet ne nje largesi prej 250 km larg Fierit, largesi kjo qe do te paraqese problematika per furnizimin e rregullt ditore te kopshteve, cerdheve dhe konvikteve duke prishur rendin e perditshem te servirjes se mengjesit ne nje orar te hershem te ketyre te fundit. Si rrjedhje nuk mund te marrim persiper absolutisht kualifikimin tuaj duke patur parasysh keto elemente: relievin e thyer malor; kushtet atmosferike gjate periudhes vjeshte-dimer; defektet qe mund te pesoje mjete gjate rruges etj.”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën nr. 9, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Operatorët ekonomike pjesemarrës duhet të kenë ne pronesi / ose kontrate qeraje / ose kontrate sherbimi me: Furre buke; Njese tregtare ushqimore; Njese Prodhimi Bulmeti ose Njese Tregtimi Bulmeti te shoqerura me akt-miratim higjeno-sanitar te leshuar nga organet kompetente te Ministrise se Shendetesise”

III.2.2.Në nenin 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.2.3. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*”

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik “Sinani Trade” sh.p.k, pasi ka paraqitur dokumentacion mbi disponimin e furrës së bukës në fshatin Libonik të Korçës, e cila ndodhet rreth 250 km larg qytetit të Fierit, e për rrjedhojë kjo largësi do të paraqiste problematika për shkak të kësaj largësie. Komisioni risjellë në vëmendje se, autoriteti kontraktor për përmbushjen e kriterit të vendosur në shtojcën nr. 9, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka përcaktuar se operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin dokument provues për disponimin (*pronësi / ose kontratë qeraje / ose kontratë shërbimi*), si dhe akt-miratim higjeno-sanitar të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu konstatohet se, autoriteti kontraktor, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, nuk ka përcaktuar kufizime mbi largësinë e furrës së bukës, apo të ketë përcaktuar në mënyrë eksplicite vendin se ku duhet disponohet ky aset i kërkuar, cka do të thotë se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimiues për arsyen e sipërcituar, bie ndesh me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë dokumentacionin e nevojshëm, i cili duhet dorëzuar në përmbushje të kriterit të vendosur në dokumentat e tenderit, në përputhje me nenin 28, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimiues “Sinani Trading” sh.p.k., qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Lel” sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *“[...]Per drejtuesin qe eshte paraqitur Libreza e shendetit, nuk ka asnje dokument qe te vertetoje qe eshte shofer. [...]”*, nga shqyrtimi i dokumentave që Komisioni i Prokurimit Publik disponon në lidhje me këtë procedurë prokurimi, u konstatua si vijon:

III.3.1. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 2779/4 Prot. datë 28.03.2018, kthen përgjigje, duke informuar se pretendimi i operatorit ekonomik “Lel” sh.p.k. në lidhje me arsyen e skualifikimit të sipërcituar, është shqyrtuar dhe është marrë parasysh. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ky pretendim i operatorit ekonomik “Lel” sh.p.k. është pranuar nga

autoriteti kontraktor, ndaj nuk do të merret në shqyrtim në themel pasi nuk ekziston më si objekt ankimi.

III.4.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Lel” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *“Mungon librezë e shëndetit te nje drejtuesi te mjetit”*. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1.Në shtojcën nr. 9, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.3 Operoret ekonomike pjesemarrës duhet të kenë ne pronesi / ose me qera 2 automjete (nga te cilet 1 te jete frigoriferik) te pershtatshem per transportin e mallrave objekt prokurimi, per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtem: •Lejen e qarkullimit te mjetit, shoqeruar me akt-miratim higjeno-sanitar te mjetit, •Librezat shendetesore te drejtuesve te mjeteve, te leshuar nga organet kompetente te Ministrise se Shendetesise, •Ne rast se mjetet jane me qera, operatori duhet te paraqese kontratat e qerese te mjetit”

III.2.2.Në nenin 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.2.3. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet *2.Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”*

III.2.4.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik “Lel” sh.p.k, pasi nuk ka paraqitur librezë shëndetësore për një drejtues mjeti, ndërkohë që ky i fundit e ka paraqitur një të tillë (nr.0036212). Komisioni risjellë në vëmendje se, autoriteti kontraktor për përmbushjen e kriterit të vendosur në shtojcën nr. 9, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka përcaktuar se operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin librezë shëndetësore për drejtuesit e mjeteve të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë. Por në asnjë rast nuk ka përcaktuar, në mënyrë eksplicite numrin e drejtuesve të mjeteve të nevojshëm, në mënyrë që operatorët ekonomik pjesëmarrës të paraqesin dokumentacionin e tyre. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë dokumentacionin e nevojshëm, i cili duhet dorëzuar në përmbushje të kriterit të vendosur në

dokumentat e tenderit, në përputhje me nenin 28, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*. Në këto kushte, KPP gjykon se se skualifikimi i operatorit ekonomik ankmuies për arsyen e sipërcituar, bie ndesh me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 28, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Lel ” sh.p.k., qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ”Sinani Trading” sh.p.k, për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me objekt, *“Blerje produkte ushqimore”*, me nr. REF-42492-01-29-2018, me fond limit 21,860,242 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Lel” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorëve ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k. dhe “Lel” sh.p.k. si dhe të korrigjojë shkeljet, duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Sinani Trading” sh.p.k. dhe “Lel” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 669 protokoli Datë 03.04.2018; Nr. 675 protokoli Datë 04.04.2018;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar

Leonard Gremshi

Anëtar

Hektor Balluku

Anëtar

Kleves Janku

Anëtar

Odise Moçka

Kryetar

Evis Shurdha